

**AKTI I THEMELIT**  
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Tech-Line” shpk**

Sot, në datë 01.06.2022, unë themeluesi, Klei Alimerko, atësia Kujtim, shtetas shqiptar, numër personal J70420092A, i datëlindjes 20.04.1997, lindur në dhe banues në Vlorë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1**  
**Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Tech-Line” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2**  
**Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :
  - a) Ofrimi i shërbimeve të teknologjisë dhe Informacionit (TI); dizenjim software, zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, testim software, dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit, dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë, hostim dhe mirëmbajtje hostim, zhvillim sistemesh migrimi, përmirësim/përditësim sistemesh informatike, operim, menaxhim, suporti i përdorimit dhe auditimi teknik/informatike për sistemet software, promovim/marketing online, konsulencë mbi sistemet e informacionit; brenda dhe jashtë vendit.
  - b) Ofrimi i shërbimeve të trajnimit profesional në fushën e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe shërbime të tjera të ngjashme
  - c) Importin dhe eksportin e pajisjeve informatike, marrjen dhe dhënien me qira të sotwareve dhe sistemeve të tjera të informacionit, shitjen me shumicë dhe pakicë së materialeve e pajisjeve informatike, shërbime të mirëmbajtjes së rrjeteve kompjuterike dhe shërbime e aktivitete të tjera të ngjashme.
- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4**  
**Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Autostrada Durrës-Tiranë. KM 6, Xhafzotaj, Kapanoni me numër pasurie 14/100, Zona Kadastrale 3852, Volumi 19, Durrës.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 12,000 (Dymbëdhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (Një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku Klei Alimerko.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**  
**Administratori**

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet Ted Alimerko, atësia Kujtim, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J91115091I, i datëlindjes 15.11.1999, lindur në Vlorë, dhe banuese në Vlorë; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

\*\*\*

**ORTAK I VETËM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"Tech-Line" shpk**

  
Klei Alimerko  
(Emër, Mbiemër, Firma)